

BASHKIMI DEMOKRATIK MINORITETIT ETNIK GREK

OMONOIA

DEKLARATË PËR SHTYP

Lënda: Të pabazura, jo reale, të papranueshme dhe për pasojë të refuzuara rezultatet e Procesit të Regjistrimit Popullsisë përsa i përket demografisë së Minoritetit autokton Etnik Grek.

Duke patur shkelur çdo normë të natyrës statistikore, për më tepër praktikat e mira të qasjes në të dhëna sensibile për identitetin etnik të qytetarëve, gjuhën amtare dhe besimin fetar, me metoda të mekanikës pushtetare të përpunimit të supozuar, Autoriteti kompetent Statistikor i Shtetit – INSTAT, shpalli sot rezultatet.

Duke qenë se në kohë, para se të filloj, gjatë periudhës së zhvillimit të fazës së mbledhjes dhe regjistrimit të të dhënave, kishim shprehur shqetësimet tona, për synimet reale të procesit Cens-23, përsa i përket Minoritetit Etnik Grek, nuk na befason rezultati që shteti publikoi.

E refuzojmë atë meqëse procesi ishte i pabesueshëm dhe një herë akoma synonte në politika të tkurrjes artificiale të kapaciteteve të MEG dhe për më tepër në vijimin e politikave të diskriminimit, represionit dhe zhbërjes së tij, në veçanti në treva të caktuara dhe në elementë përbërës të tij aty ku shteti në mënyrë abuzive refuzon t'i njoh dhe sanksionojë si të tilla.

Posaçërisht duam të shprehim shqetësimin përsa i përket dimensionit të tablosë përbërjes fetare që sot prezantoi Autoriteti Statistikave. Meqëse shumica dërrmuese e pjesëtarëve të Minoritetit Etnik Grek dhe komunitetet e saj lokale i përkasin Kishës Orthodhokse, nuk mundemi të mos denoncojmë persistencën për të fiksuar e madhësisë numerike për Orthodhoksët, larg realitetit dhe atyre sa konfirmohen historikisht. Nuk është ogur i mirë për bashkëekzistencën paqësore në vend dhe as i shërben imazhit të mirë që ka nevojë.

Bashkangjitur raport i zgjeruar i Këshillit të Përgjithshëm për argumentimin e vendimit të refuzimit së rezultateve të Regjistrimit nga ana jonë.

Nga Zyra e Shtypit dhe Komunikimit

BDMEG OMONOIA

Sarandë, më 28 Qershor 2024

BASHKIMI DEMOKRATIK MINORITETIT ETNIK GREK

OMONOIA

Këshilli Përgjithshëm

RAPORT INFORMUES

Lënda: I pabazë Procesi i Regjistrimit të Popullsisë Cens-2023 – Të pabesueshme dhe të papranueshme rezultatet e Autoritetit Statistikave – INSTAT.

Kërkesë diakronike e Minoritetit Etnik Grek, sikundër është formuluar nga BDMEG OMONOIA, me rënien e regjimit komunist, mbetet ajo për realizimin e një procesi të besueshëm, mbështetur në parimin e vetdeklarimit dhe sipas standarteve më të mira ndërkombëtarë, për rilevimin e demografisë dhe gjeografisë së pjesëtarëve të tij. Kjo sepse gjatë periudhës pesëdhjetëvjeçare të regjimit të privimit të lirive dhe para tij, janë zbatuar politika të tkurrjes “artificiale” të dinamikës demografike të MEG – pa përjashtuar minoritete të tjera – me intensitet të veçantë në rajone të caktuara dhe për grupe sociale të veçantë (përbërës të Minoritetit Etnik Grek autokton) si dhe gjithashtu manipulime abuzive në regjistrat e gjendjes civile me synym stabilizim të ashtuquajturave “zona minoritare” gjeografikisht të kufizuara sipas planifikimeve të regjimit.

Madje kërkesa ka përkrahjen dhe parashtrohet me ngulm nga organizma ndërkombëtarë dhe qeveri aleate, që nga njëra anë mbështesin shtetin Shqipërisë në modernizimin e tij dhe maturimin në standartet dhe realitetet Europiane, dhe nga ana tjetër synojnë aplikimin e praktikave më të mira në mbrojtjen dhe promovimin e minoriteteve sipas parimit të barazisë së qytetarëve dhe para ligjit.

Në procedurën respektive të Regjistrimit Popullsisë dhe Banesave 2001, BDMEG OMONOIA, meqëse nuk pati reflektim që në pyetësonin adekuat të përfshihen rubrika për mbledhjen e të dhënave që lidhen me identitetin etnik, gjuhën amtare dhe besimin fetar të qytetarëve, drejtoi thirrje pjesëtarëve të MEG të bojkotojnë procesin. Këtë e pasuan edhe minoritetet e tjera – etnike, gjuhësore ose kulturore në vend – dhe qëllim kishte sensibilizimin e opinionit publik dhe posaçërisht të faktorit ndërkombëtar në trajtimin e nevojës dhe kërkesës në fjalë.

Në përsëritjen e rradhës, pasi kaloi dhjetëvjeçari, të procesit të Regjistrimit Përgjithshëm Popullsisë dhe Banesave 2011, ndërsa formalisht dhe në përmbushje të kushtit të Këshillit Europës dhe BE për financim të ndërmarrjes, u shpall predispozicioni për mbledhje fakultative të dhënave që lidhen me karakteristikat më lart, në fakt si përmes pyetësonit ashtu edhe metodologjisë në përgjithësi refuzohej parimi i vetidentifikimit. Parashikohej bile gjobë penalizuese në rastin kur konstatohej se deklarimi i qytetarit nuk përputhej me të dhënat e manipuluar të regjistrave gjendjes civile.

Mjete të informimit masiv dhe organizata të spektrit nacionalist ndërmorrën fushatë të papranueshme të përballimit ekstrem nacionalist dhe racist të çështjes duke krijuar atmosferë mbytëse.

Këto arsye shpunë në përsëritje të thirrjes nga ana e BDMEG OMONOIA që pjesëtarët e Minoritetit Etnik Grek të mos marrin pjesë në proces. Në të njëjtën linjë vijuan edhe organizata që përfaqësojnë minoritete të tjera.

Komunitetet fetare, Kisha Orthodhokse në veçanti, në vijim refuzojnë rezultatet që shpalli Autoriteti Statistikor, duke i konsideruar ato të papranueshme dhe të siguruara në rrethana të dyshimta dhe përpunuara me paragjykime.

Komiteti Monitorimit Zbatimit të Marrveshjes Kuadër të Këshillit Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike në vijim adopton plotësisht këto pretendime dhe objeksione. Kërkon me këmbëngulje nga shteti Shqiptar korrigjimin e menjëhershëm të situatës me respektim të parimit të vetidentifikimit të lirë. Deri atëherë fton Qeverinë të mos marr parasysh në planifikimin e politikave adekuate për minoritetet të këtyre të dhënave.

Procedurë regjistrimi të kapaciteteve të Minoritetit Etnik Grek në shtetin e Shqipërisë ndërmerri paralelisht BDMEG OMONOIA (u plotësuan 287 000 formularë personalë, me pjesëmarrje të vlerësuar 85%). Me aplikim të një pyetësori të posaçëm, platforme dixhitale dhe respekt të rregullave të ruajtjes së të dhënave personale, rezultati i këtij procesi jo formal sjell rezultate dhe tablo, diametrikisht të kundërt me të dhënat respektive zyrtare të Autoritetit Shtetëror të Statistikave.

Në këto kushte dhe ndërsa Qeveria sanksionoi Ligj të veçantë të kërkuar fuqishëm nga minoritetet në vend dhe sidomos nga faktori ndërkombëtar, për mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, pritshmëritë nga përsëritja më e fundit të procesit të Regjistrimit Përgjithshëm Popullsisë, Banesave dhe Ekonomive – Cens 23, ishin të bazuara. Dhe kjo përse i përket dimensionit të aplikimit të praktikave adekuate më të mira, në respektim të parimit të vetidentifikimit, predispozicionit të sigurtë të autoriteteve shtetërorë në rilevimin e realitetit, në fund të fundit të disiplinimit me kondicionet e vendosura nga Këshilli i Europës dhe BE, që nga njëra anë financon procedurën dhe nga ana tjetër përbën synym integrimi për Shqipërinë.

Në këtë frymë u orientua dhe qasja e BDMEG OMONOIA në mënyrë që të kontribonte në masën e mundshme në strukturimin sa më adekuat të pyetësorit, ruajtjen në vijim të klimë pozitive, sigurimin e minimumit besueshmërisë në procesin e përpunimit dhe shpalljes së rezultateve, sensibilizimin e qytetarëve për pjesëmarrje dhe në Gjuhën amtare Greke etj.

Kërkesave të saj dhe organeve drejtuese – në koordinim dhe me lëvizje analoge që përfaqësojnë komunitete të tjera me karakteristika të minoriteteve – për bashkëpunim me Komitetin Qeveritar të Regjistrimit, mbizotëroi klimë negative dhe refuzimit nga ana e tij.

Kjo më posaçërisht përse i përket formulimit të Pyetësorit, ngritjes së Grupeve të Regjistruesve, procesin e informim – sensibilizimit etj.

Nga ana e Komitetit Qeveritar të Regjistrimit dhe Entit Statistikor – INSTAT së implementues, mbizotëroi frymë mohuese dhe shmangie të detyrimit për pjesëmarrje të përfaqësuesve të minoriteteve, posaçërisht të MEG si më i madhi, më i organizuari dhe më i interesuar për

procesin. Takime të rezervuara në momentin final dhe gjoja konsulenca me komunitetet fetare pasi ishte formatuar pyetëtori, janë pretekstuale.

Edhe një herë tjetër mbartës të mentalitetit totalitar nacionalist, duke disponuar dhe pozita shtetërorë dhe qeveritarë, u përzien me synym ushtrim të presionit jo të dëshiruar dhe daljen e procesit nga shinat.

Pavarësisht propozimeve tona konstruktive, të organizatave të minoriteteve të tjera dhe komuniteteve fetare gjatë fazës së përgatitjes të procesit nuk pati reflektim:

formulari i pyetësorit edhe kësaj rradhe ishte difuz dhe nuk i referohet me drejtësi predispozicionit për rilevim të besueshëm

grupet e mbledhjes në terren të të dhënave gjatë ngritjes së tyre nuk përfshinë persona që do të përfaqësonin të interesuarin direkt dmth Minoritetin Etnik Grek, në zona dhe njësi me popullsi të përbërë

nuk u dha asnjë mundësi besueshmërie në aksesim për përfaqësuesit adekuatë të minoriteteve që të monitorojnë zyrtarisht procesin në fushat e hollësishme të interesit

nuk pati fushatë sensibilizimi posaçërisht në gjuhën amtare dhe në bashkëpunim me organizata përfaqësuese që kanë mundësi reale të sensibilizimit për pjesëmarrje

ju shmangën ndërsa ishte mundësia për aplikim të pjesëmarrjes alternative në Regjistrim përmes platformave dixhitale sikundër dhe në vende të tjera edhe të rajonit tonë,

u drejtua thirrje pjesëtarëve të MEG për të marr pjesë aktivisht në proces ndërsa paralelisht organizuam mbikëqyrje të rreptë të zbatimit në terren të tij.

Për më tepër, ndërkaq, këmbëngulëm në komunimet me Autoritetin e implementimit të Regjistrimit, duke i mëshuar mundësive për implementimin më të mirë. Denoncuam indiferentizmin nga ana e tyre me dispozicion talljeje dhe spekulimi.

Gjatë realizimit të stadi bazik të grumbullimit të të dhënave në familje dhe nga qytetarët janë mjaftueshëm të vlerësueshme dhe të regjistruara faktet dëshmojnë se bëhet fjalë për proces farsë që vetçvlerësohet dhe shndërrohet në i pabazuar, ndërsa rezultatet e tij të pabesueshme.

Më konkretisht kemi publikisht denoncuar se:

shumë njësi familjare nuk u vizituan nga regjistruerit dhe të cilët plotësuan formularët sipas dëshirës në platformën adekuate elektronike

numri i rasteve ku regjistruerit iu shmangën parashtrim qartazi të pyetjeve ose mos regjistrim të përgjigjeve në fusha si origjina Nacionale, gjuha amtare Greke, besimi fetar Orthodhoks, është i konsiderueshëm dhe thelbësor. Posaçërisht kjo në treva ku shteti ngul këmbë të mos pranojë ekzistencën e komuniteteve të qytetarëve me përkatësi etnike Greke.

ofiqarë shtetërorë duke kumtuar kinse cilësinë e nëpunësve të administratës qendrore të Entit Statistikor – INSTAT, u paraqitën dhe implikuan në mënyrë inkompetente në proces. Kjo në treva ku qytetarët u përpoqën të aplikojnë të drejtën e vetidentifikimit gjatë regjistrimit.

përsa i përket elementit sensitiv të besimit fetar të qytetarëve janë regjistruar raste me ndikim esencial në rezultat që nxjerrin në pah tendenciozitet përsa i përket mpakjes artificiale të komunitetit Orthodhoks

mungesa e transparencës në fazën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave është e dukshme dhe nuk mund të vihet në dyshim

jo thjeshtë nuk u tregua vëmendja e duhur në çështjen e rikthimit të vizitës në banesa që momentalisht u gjendën të mbyllura, që të njoftohet i zoti dhe përsëritet vizita, përkundrazi, mbizotëroi frymë paragjykimi dhe u konsideruan të larguar pronarët duke ndikuar kështu rezultatin

në bazë udhëzimesh dhe imponimi nga “instanca eprore” regjistruesit nuk mblodhën dhe regjistruan të dhëna për pjesëtarë të tjerë të familjes që provizorisht mungonin në momentin e intervistës

Pas gjithë sa më sipër dhe të tjera që nuk përmenden në hollësi rezulton konkluzioni se **Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave Cens23 në Shqipëri, dështoi të përmbush synimet përsa i përket nxjerrjes së një rezultati objektiv, të besueshëm dhe të pranuar, për madhësitë numerike dhe gjeografinë e pjesëtarëve dhe komuniteteve lokale të Minoritetit Etnik Grek.**

Si Bashkim Demokratik MEG OMONOIA, duke refuzuar si procesin e implementimit praktik të Regjistrimit, aq edhe kryesisht rezultatet e buruara prej tij dhe që u shpallën nga enti shtetëror kompetent, rikthejmë në vëmendje idenë që të kryhet më së fundi një proces eksplicit me objektiv qasjen reale të të dhënave për minoritetet etnike, linguistike dhe kulturore.

Për më tepër imponohet kjo për të patur një imazh real dhe të pranuar përsa i përket shtesëzimit fetar të popullsisë.

Në mbështetje të sa më sipër u përmendën të nënvizohet qëndrimi i opozitës për Procesin e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave Cens23, se Qeveria duke patur të tjera predispozita dhe synime, në shkelje flagrante të standarteve të shërbimeve statistikore Europiane dhe kritereve të detyrueshme shkencore, vonoi qëllimisht publikimin e rezultateve.

Madje ndërsa ishte angazhuar INSTA për të publikuar të dhënat paraprake më 18 Qershor, u anulua për në fund të muajit.

Media të Informimit Masiv të pavaruara kanë raportuar kohë pas kohe dhe në vijim, investigime të tyre të posaçme përsa i përket si fazës së procedurës së mbledhjes së të dhënave aq edhe regjistrimit, ruajtjes dhe përpunimit të tyre për publikim.

Sarandë, 28 Qershor 2024